

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo			CAA
Nr. i prot. / Prot. No.	2024/ZDP/90		
Br. prot. / Prot. No.			
Faqe / Pages	Kopje / Copy	Data / Date: 11.03/2024	
Stranica/Pages	Kopija/Copy	Datum/Date	
Hyrës/ulazno/in	<input type="checkbox"/>		
Dalës/zlazno/out	<input checked="" type="checkbox"/>		
Brendshëm/interno/internal	<input type="checkbox"/>	Prishtinë/Prishtina/Pristina	

05/ZDP/VE/2024  
Datë: 11 Mars 2024

Në mbështetje të neneve 2, 14.2, 35, 36 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, nenit 24 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizmin dhe Funkcionin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Marrëveshjes për Shërbime të Rregullta Ajrore ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit Federal të Zvicrës, të datës 30 Nëntor 2010 dhe Memorandumit të Mirëkuptimit për marrëveshje për shërbime ajrore të datës 29 Prill 2009 në mes të Autoriteteve të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës dhe Këshillit Federal të Zvicrës,

Duke vepruar në mbrojtje të interesit publikut dhe atë shtetëror, me synim të sigurimit të shërbimeve të mira me çmime konkurrenente për shërbime ajrore,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil (me tutje "AAC") nxjerr këtë:

## VENDIM

- Për shpallje të Thirrjes publike për operatorët ajror të cilat mund të ofrojnë plane fluturimi dhe kapacitete me orar të programuar fluturimesh për të fituar të drejtën e fluturimit përmes emërimit (dezignimit) në destinacionet në mes të Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës, dhe anasjelltas.
- Kriteret për t'u autorizuar si operator ajror për ushtrim të të drejtave nga pika 1, janë të bashkangjitura si Aneks i këtij Vendimi.
- Të gjitha palët e interesuara, mund të dorëzojnë shprehjen e interesit të tyre në AAC deri më 25 mars 2024.
- Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

  
Alban Ramabaja  
UD. Drejtor i Përgjithshëm

Vendimi i dërgohet:  
– Ministrit të MMPHI; dhe  
– Arkivit të AAC-së.

## Thirrje publike për shprehje interesi

Thirrje publike për operatorët ajror të cilat mund të ofrojnë plane fluturimi dhe kapacitete me orar të programuar fluturimesh për të fituar të drejtat e trafikut përmes emërimit (designimit designation) në destinacionet në mes të Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës.

### Autorizimi për Emërim dhe operim të operatorëve ajror (Dezignim; Eng. Designation)

Dezignimi është proces i emërimit të operatori/ëve ajror për shfrytëzim të të drejtave të fluturimit mes dy vendeve dhe si e drejtë e shteteve nënshkruese të një Marrëveshjeje bilaterale për Shërbime Ajrore.

Në Marrëveshjen për Shërbime Ajrore midis Kosovës dhe Zvicrës të vitit 2009 të dy palët janë pajtuar që mund të emërojnë numër të pakufizuar të operatorëve ajror vendës që të operojnë mes të dy shteteve. Megjithatë Kosova nuk ka kompani ajrore vendëse, në Marrëveshjen Dypalëshe Zvicra është pajtuar që Kosova mund ta emërojë (dezignojë) një operator ajror të BE-së ose të Zvicrës.

Qëllimi dhe kreu i procesit të dezignimit gjithmonë bëhen për të mbrojtur interesin e publikut dhe atë shtetëror, me synim të kufizojë monopolin dhe rrjedhimisht edhe të sigurojë edhe shërbime të mira me çmime konkurrense dhe të arsyeshme për udhëtarët nga një operator ajror i huaj me qëndrueshmëri operacionale dhe financiare.

Për Kosovën, Zvicra është tregu më i madh për nga numri i udhëtarëve (36% më 2023) dhe çmimet e biletave tradicionalisht janë shumë të larta, veçanërisht prej Cyrihut që është pas Bazelit destinacioni i dytë më i shërbyer nga Prishtina. Dezignimi nga Kosova i një operatori ajror që ofron konkurrencë të drejtë në treg do t'i kontribuojë interesit publik duke ofruar shërbime të rregullta ajrore me çmime të arsyeshme.

Zakonisht shtetet dezignojnë kompaninë e tyre flamurtare (flag carrier) dhe pastaj nëse lejohet dezignim i shumëfishtë edhe i kompanive të tjera të tyre kjo bëhet në marrëveshje me shtetin tjetër duke mbrojtur parimin e interesit të publikut dhe të reciprocitetit. Të dhënat statistikore tregojnë se nga Zvicra janë të emëruar pesë (5) operator ajror me flamur të Zvicrës për shërbime ajrore mes Kosovës dhe Zvicrës, përderisa Kosova mund të emëroj/dezignoj vetëm një (1) operator ajror të huaj.

Në Marrëveshjen dypalëshe midis Kosovës dhe Zvicrës dezignimi përcaktohet me Nenin 5 të Marrëveshjes dhe Nenin 2 të MOU në të cilin janë precizuar kriteret në bazë të të cilave Zvicra në mungesë të operatorit me AOC të Kosovës pranon të japë jo më shumë se një (1) autorizim operimi për kompani të huaja të dezignuar nga Kosova.

## Kriteret për operatorët ajror të Emëruar/Dezignuar nga Kosova për në Zvicër për shërbime ajrore

Operatorët Ajror (kompanitë ajrore) që shprehin interesin për marrjen e emërimit/dezignimit nga Republika e Kosovës për ofrimin e shërbimeve ajrore vajtje-ardhje Kosovë – Zvicër, duhet të plotësojnë kushtet e përshkruara në vijim.

### 1. Operimi i biznesit

1.1 Regjistrimi i biznesit në Kosovë (certifikata e biznesit);

1.2 Certifikata e Operimit Ajror (COA) nga një shtet anëtar i BE-së ose Zvicrës.

1.3 Vendi kryesor i biznesit të operatorit ajror të jetë nga shteti që ka lëshuar COA.

1.4 Të jetë dhe të vazhdojë të jetë në pronësi të drejtpërdrejtë ose me shumicë të pronësisë nga Kosova, Zvicra, ose nga shtetet anëtare të Komunitetit Evropian, dhe/ose shtetasit e Kosovës, Zvicrës, ose shteteve anëtare të Komunitetit Evropian.

1.5 Nuk është në partneritet apo në pronësi pjesërisht ose plotësisht të operatorëve ajror dhe/ose pronarëve të tyre që mbajnë një COA dhe Licencë Operimi (LO) nga Zvicra dhe që janë të autorizuar të kryejnë shërbime ajrore nga shteti i Zvicrës për në Kosovë dhe anasjelltas.

1.6 Të ofrojë dëshmi se ka operuar me bilanc pozitiv financiar së paku në dy vitet e fundit për të dëshmuar qëndrueshmërinë financiare.

1.7 Të dorëzojë një garancion bankar në emër të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës në vlerë prej 100,000 EUR i cili do të ekzekutohet në rast të mospërmbushjes së detyrimeve.

(Të dorëzohet jo më vonë se një muaj para fillimit të operimeve).

### 2. Kriteret e performancës për kapacitetet operacionale dhe shërbimet e operatorit ajror

2.1. Të ketë në dispozicion për operim ajror së paku 3 aeroplan për shërbime ajrore nga Kosova në Zvicër e anasjelltas me kapacitet së paku 150 ulëse.

2.2. Më së voni deri në fund të sezonit veror të fluturimeve (IATA SS 2024) të bazojë në Prishtinë të paktën 2 aeroplan të cilët i posedojnë kapacitetin së paku 150 ulëse.

*\*Në rast se paraqitet nevoja të përdoren aeroplanë me kapacitet më të vogël të ulëseve, numri minimal prej 150 ulëse duhet të kompenzohet me numër më të madh të fluturimeve për të kompenzuar apo tejkaluar numrin minimal prej 150 udhëtarëve për çdo aeroplan sipas numrit minimal të fluturimeve të kërkuara në baza javore për secilin destinacion (sipas 3.1, 3.2, 3.3).*

2.3. Të sigurojë se ka në dispozicion shërbime të mirëmbajtjes për mjeteve ajrore në shfrytëzim në ANP "Adem Jashari" për ndonjë intervenim të nevojshëm.

2.4. Të dëshmojë kapacitetin e mjaftueshëm të flotës dhe ekuipazhit të aeroplanëve, ose një marrëveshje kontraktuale me operator tjerë ajror për të sjellur/zëvendësuar aeroplanë dhe/apo ekuipazhin në rast të defektit të aeroplanit apo çfarëdo problemi tjerër që kërkon të zëvendësohet aeroplani apo ekuipazhi i fluturimit.

2.5. Operatorët ajror që kanë operuar me performancë pozitive me së paku 100.000 pasagjerë për/nga ANP "Adem Jashari" gjatë vitit paraprak (2023).

2.6. Ofertimi dhe shitjen e shërbimeve ajrore në Zvicër dhe Kosovë edhe përmes kanaleve/shërbimeve direkte tek konsumatori.

2.7. Të fillojë shërbimet e rregullta ajrore vajtje-ardhje nga Prishtina për në Cyrih, Gjenevë dhe Bazel më së largu deri më 1 qershor 2024.

2.8. Të ofrojë udhëzimet në bord të aeroplanit në gjuhën shqipe, dhe së paku një personel të ekuipazhit që flet gjuhën shqipe për asistencë tek udhëtarët me nevojë më së largu në fund të vitit 2024.

2.9. Të prezentojë një plan shkollimi dhe punësimi për shtetasit e Kosovës, për pilot dhe personel tjerë të ekuipazhit dhe shërbimeve mbështetëse në operimin e aeroplanëve, që fillon jo më larg se në vitin e dytë të operimit.

### 3. Frekuenca e fluturimeve

Të ofrojë numrin sa më të madh frekuencash të fluturimeve të rregullta ditore, javore dhe vjetore vajtje-ardhje nga Prishtina për në Zvicër, por jo më pak se:

3.1. Shtatë (7) herë në javë gjatë tërë vitit në shërbime ajrore (fluturim vajtje-ardhje) midis Prishtinës dhe Cyrihut, jo vetëm ditëve të vikendit. Fluturimi kthyes të jetë jo më vonë se 48 orë nga fluturimi paraprak

3.2. Tri (3) herë në javë gjatë tërë vitit në shërbime ajrore (fluturim vajtje-ardhje) midis Prishtinës dhe Gjenevës dhe jo vetëm ditëve të vikendit. Fluturimi kthyes të jetë jo më vonë se 72 orë nga fluturimi paraprak.

3.3. Dhjetë (10) herë në javë gjatë tërë vitit në shërbimet ajrore (fluturim vajtje-ardhje) midis Prishtinës dhe Bazelit dhe jo vetëm ditëve të vikendit. Fluturimi kthyes të jetë jo më vonë se 48 orë nga fluturimi paraprak.

3.4 Brenda tërë vitit kalendarik të realizohen jo më pak se 1000 (një mijë) fluturime (fluturim vajtje-ardhje), me mesatarën e kapacitetit të mbushur të aeroplanit (loadfactor) jo më pak se 90%.

3.5 Operatorët ajror që i plotësojnë kriteret e parapara, mund të paraqesin planin dhe ofertën me minimumin e kërkuar të frekuencave të fluturimeve gjatë vitit për shërbime ajrore vajtje-ardhje për secilin destinacion mes Kosovës dhe Zvicrës, apo të ofrojnë numër sa më të madh të frekuencave të fluturimeve të programuara.

3.6 Operatori ajror duhet të përmbushë të paktën 90% të detyrimet e tij në lidhje me frekuencat e fluturimeve në destinacionet e caktuara si dhe kapacitetin e shfrytëzimit të aeroplanit (load factor),

dhe të paraqesë në AAC raportin e detajuar mbi aktivitetin për sezonin e mëparshëm IATA jo më vonë se tri (3) javë nga fillimi i sezonit të ri të fluturimeve sipas IATA.

#### AFATI KOHOR – PERIUDHA E EMËRIMIT/DEZIGNIMIT

- Dezinimi do të jepet për një periudhë tre (3) vjeçare me mundësi vazhdimi pas vlerësimit të përvjetshëm pozitiv nga AAC për përmbushjen e të paktën 90% të kriterëve të detyrueshme dhe të zotuar në lidhje me frekuencat në destinacione e caktuara dhe kapacitetin e shfrytëzimit të aeroplanit (load factor), përmes raportit të detajuar mbi aktivitetin e mëhershëm për secilën 'IATA Sezonë', përveq nëse bëhet ndryshim i kriterëve dhe kushteve tjera që imponojnë rrethanat.
- Dezinimi do të tërhiqet në rast të fillimit të operimit të një kompanie ajrore të Kosovës, ose në rast të mospërmbushjes së detyrimeve të zotuar.

#### DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT, AFATET DHE KONSULTIMET

- Dokumentet mund të dorëzohen përmes postës elektronike në [infocaa@caa-ks.org](mailto:infocaa@caa-ks.org) ose kopje fizike direkt në zyret e AACK përmes shërbimit protokollar në adresën: Rr. Zejnel Salihu Nr. 22, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.
- Afati i dorëzimit të dokumentacion është deri me datë 25 Mars 2024, në orën 16.00.
- Kontakti për sqarime dhe konsultime të nevojshme: [infocaa@caa-ks.org](mailto:infocaa@caa-ks.org)